



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-KOSOVA CUMHURIYETI
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Glavni Centar za Porodično Zdravstvo
Aile Hekimliđi Genel Merkezi

Nr.Br.No.

20/5

Me,Dt.

12.02.2025

PRIZREN



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË

RAPORTI VJETOR I PUNËS I DREJTORISË KOMUNALE TË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2024

Përmbajtja e raportit

- Hyrje dhe pasqyrim i shkurtër i statusit të realizimit të projekteve nga investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetet e tjera të DKSH	3
- Të dhënat mbi buxhetin e shpenzuar nga kategoritë buxhetore për vitin 2024.....	8
1. Investimet kapitale.....	10
1.1. Furnizimi me autoambulanca.....	11
1.2. Furnizimi me mamograf.....	12
1.3. Ndërtimi i QMF-së në fshatin Korishë.....	13
1.4. Ndërtimi i QKMF-së në ish kampin e KFOR-it.....	14
1.5. Ndërtimi i QMF-së në lagjen e Trimave (Tusuz).....	15
1.6. Blerja e aparaturave jo mjekësore.....	16
1.7. Digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike.....	16
1.8. Furnizimi me aparatura stomatologjike.....	17
1.9. Blerja e aparaturave mjekësore.....	17
1.10. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH.....	18
2. Mallrat dhe shërbimet.....	19
3. Shpenzimet komunale.....	23
4. Shërbimet shëndetësore.....	24
4.1. Vizitat mjekësore.....	25
4.2. Vaksinimi.....	26
4.3. Shërbimi i njësisë diabetike.....	27
4.4. Shërbimet laboratorike.....	27
4.5. Shërbimet radiologjike.....	28
4.6. Shërbimi urgjent.....	29
4.7. Kujdesi shtëpiak.....	29
4.8. Ndërrimi i natës.....	30
4.9. Shërbimet stomatologjike.....	30
4.10. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë.....	31
4.11. Shërbimet nga departamenti për shëndetin e gruas.....	32
4.12. Shërbimet nga barnatorja qendrore.....	33
4.13. Shërbimet e tjera shëndetësore.....	34
5. Subvencionet.....	35
6. Shënimi i Ditëve Botërore të ndryshme.....	36
7. Aktivitete të tjera të drejtorisë.....	40

Drejtoria e Shëndetësisë gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe punësh të cilat i ka pasur të planifikuara me planin e punës për vitin 2024.

DKSH përveç se ka ofruar shërbimet e rregullta shëndetësore për pacient përmes QKMF-së, në aspektin procedural ka filluar me procedurat e nevojshme për realizimin e projekteve të parapara, duke parashtruar kërkesat tek zyra e Kryetarit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me projektet si dhe ka përpiluar specifikacionet dhe paramasat për projektet e parapara dhe pas marrjes së vendimeve përkatëse nga ana e Kryetarit, janë hapur procedurat e tenderimit, ku më pas janë nënshkruar kontratat përkatëse për këto projekte dhe janë kryer furnizimet, punët ose shërbimet sipas këtyre kontratave.

Për projektet të cilat kanë qenë në fuqi kontratat nga vitet e kaluara, kanë vazhduar punët, furnizimet apo shërbimet sipas atyre kontratave.

Gjatë kësaj kohe, janë pranuar kërkesat për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara me rregulloren për ndarjen e subvencioneve si dhe janë realizuar pagesat për këto kategori, sipas kërkesave të parashtruara.

Më poshtë gjeni pasqyrën e projekteve, aktiviteteve, shërbimeve, etj., të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe në kuadër të DKSH.

PROJEKTET, AKTIVITETET, SHËRBIMET DHE PUNËT E PLANIFIKUARA DHE TË KRYERA NGA DKSH GJATË VITIT 2024

INVESTIMET KAPITALE

Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Furnizim me Autoambulanca për QKMF	Realizuar	Nuk ka
Furnizim me Mamograf	Realizuar	Nuk ka
Ndërtimi i QMF në fshatin Korishë	Realizuar	Nuk ka
Ndërtimi i QKMF në KFOR	Në proces të realizimit	Kontratë 3 vjeçare
Digjitalizimi i shërbimeve laboratorike	Pezulluar	Nuk është parë si i nevojshëm realizimi i këtij projekti në rrethanat aktuale
Ndërtimi i QMF në lagjen Tusuz	Në proces të realitimit	Kontratë 3 vjeçare
Blerja e aparaturave jo mjekësore (elektronike, gjenerator)	Realizuar	Nuk ka
Blerja e aparaturave mjekësore	Realizuar	Nuk ka
Blerja e aparaturave stomatologjike	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH	Realizuar	Nuk ka

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Furnizim me reagenca laboratorike	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me material shpenzues sanitar	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me barna për nevojat e QKMF-së	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me filma të RTG	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Furnizim me material stomatologjik	Në proces të realizimit	Nuk ka
Furnizim me uniforma të punës për personelin shëndetësor	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me libreza sanitare	Dështuar	Nuk ka pasur ofertues
Furnizimi me material higjienik	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Furnizimi me material administrativ	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi me pelet për nevojat e KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi me dru për nevojat e objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Nuk ka
Furnizimi me oksigjen (gaz medicinal)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Përpunimi statistikor i të dhënave të dala nga realizimi i vizitave sistematike për nxënësit e klasave I, V dhe IX të Komunës së Prizrenit të realizuara më 2023 dhe 2024	Realizuar	Nuk ka
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së (Projekt nga viti i kaluar)	Realizuar	Është realizuar deri në muajin maj 2024, më pas është shpenzuar vlera e paraparë e kontratës
Trajnimi i profesionistëve shëndetësor të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Sigurimi fizik i objekteve të KPSH	Realizuar	Kontrata ka përfunduar në korrik 2024, procedura e re në OSHP
Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i të gjitha objekteve e shëndetësisë primare	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me shujta ditore për profesionistët shëndetësor që merren me realizimin e vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka
Furnizim me paisje shtëpiake për nevojat e KPSH	Realizuar	Nuk ka

Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mirëmbajtja e paisjeve mjekësore	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Mirëmbajtja e paisjeve teknike	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mbushja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mirëmbajtja e oborreve të objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Furnizimi me vula për QKMF, QMF, AMF	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me ID kartela për puntorët e QKMF	Në proces të realizimit	Pritet furnizimi sipas kontratës
Mbikëqyrja e projekteve të DKSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të Komunës së Prizrenit dhe QKMF	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Furnizimi me tharëse për duar për nevojat e KPSH	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me inventar për zyre		
Sigurimi i automjeteve zyrtare të QKMF	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me çarshaf për nevojat e KPSH	Realizuar	Nuk ka

SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Emri i shërbimit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Vizitat mjeksore nga mjeku i përgjithshëm dhe mjeku specialist i mjeksisë familjare	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i vaksinimit të rregullt nga kalendari i obliguar për fëmijë	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i vaksinimit kundër Covid-19 dhe gripit sezonal	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – analizat laboratorike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – radiologjik	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i njësisë diabetike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi urgjent	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e kujdesit shtëpiak (paliativ, geriatrik, për personat me	Realizuar	Nuk ka

aftësi të kufizuar)			
Shërbimet mjekësore nga ndërrimi i tretë (24h)	Realizuar		Nuk ka
Shërbimet stomatologjike	Realizuar		Nuk ka
Shërbimet shëndetësore si EKG, EHO, inhalime, fashime, injeksione, infuzione, etj.	Realizuar		Nuk ka
Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	Realizuar		Nuk ka
Vizita specialistike dhe këshillimore nga mjeku gjinekolog, internist, pediatër.	Realizuar		Nuk ka
Shërbimet nga barnatorja qendrore e QKMF-së	Realizuar		Nuk ka
Shërbimet e transportit për të sëmurët me dializë	Realizuar		Nuk ka
Këshillime, udhëzime, etj.	Realizuar		Nuk ka

SHËNIMI I DITËVE BOTËRORE

Emri i Ditës Botërore	Statusi i Realizimit	Vërejtje
Dita Botërore e Kancerit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e TBC	Realizuar	Nuk ka
Java Botërore e Imunizimit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Hipertensionit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore kundër abuzimit të drogave	Realizuar	Nuk ka
Muaji i Kancerit të Gjirit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Diabetit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore kundër HIV/AIDS	Realizuar	Nuk ka

AKTIVITETE TË TJERA


Emri i aktivitetit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Vizita njoftuese nëpër institucionet e KPSH	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i trajnimeve për personelin e Shërbimit Urgjent në bashkëpunim me KFOR-in Italian	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i vizitave sistematike në shkolla për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9	Realizuar	Nuk ka
Pranimi i një donacioni me paisje mjekësore dhe jo mjekësore nga CIMIC në kuadër të KFOR-it Italian.	Realizuar	Nuk ka

Pranimi i donacionit nga KFOR-i Italian për QMF Mushnikovë me paisje për këtë QMF	Realizuar		Nuk ka
Përurimi i hapësirave të renovuara tek Lartorja e QKMF-së, investim ky i ardhur si donacion nga KFOR-i Turk	Realizuar		Nuk ka
Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet DKSH dhe Shoqatës për Mbrojtjen e Pacientëve të Kosovës	Realizuar		Nuk ka
Organizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike të nxënësve nëpër shkollat e Komunës së Prizrenit	Realizuar		Nuk ka
Pranimi i donacionit me paisje mjekësore dhe jo mjekësore nga Ambasada e Bullgarisë.	Realizuar		Nuk ka
SUBVENCIONET			
Emri i projektit	Statusi i realizimit		Vërejtje
Mbështetja financiare për kategoritë e përcaktuara për mbështetje financiare nga DKSH sipas rregullores për subvencione të Komunës së Prizrenit.	Realizuar		Nuk ka

Në vijim do të shpalojmë raportin e detajizuar për secilin projekt, shërbim dhe aktivitet të realizuar nga DKSH.


DKSH, për vitin fiskal 2024 ka pasur në dispozicion buxhetin prej **8,314,241.00** eurosh, i cili ka qenë i dedikuar për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve dhe komunalive. Buxheti i shpenzuar për kategorinë e subvencioneve për kërkesat drejtuar DKSH për mbështetje financiare, është realizuar nga mjetet të cilat kanë qenë nën menaxhimin e zyrës së Kryetarit të Komunës.

Nga shuma totale e buxhetit të planifikuar, DKSH ka shpenzuar **8,126,069.80** euro ose **97,74 %** të buxhetit në të gjitha kategoritë. Në grafikonin e mëposhtëm mund të gjeni pasqyrën e saktë të shpenzimit të këtyre mjeteve gjatë kësaj periudhe.




Për secilën kategori, ky ka qenë parashikimi i mjeteve për vitin 2024:

Shumat e planifikuara sipas kategorive buxhetore



Bazuar në kategoritë buxhetore, më poshtë gjeni grafikonin i cili pasqyron shpenzimin dhe mbetjet e mjeteve për këtë periudhë sipas këtyre kategorive.



Në vijim gjeni raportet detale për secilën kategori, përkatësisht projekt.

1. Investimet kapitale

Nga kategoria e investimeve kapitale, DKSH ka pasur të planifikuara realizimin e projekteve si më poshtë për vitin 2024:

1. Furnizim me autoambulanca për QKMF
2. Furnizim me aparat të mamografisë
3. Ndërtimi i QKMF-së në KFOR
4. Ndërtimi i QMF-së në lagjen Tusuz
5. Blerja e aparaturave jo mjekësore (elektronike, kamera, gjenerator, teknika e bardhë, etj.)
6. Digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike
7. Furnizim me aparatura stomatologjike
8. Furnizimi me aparatura mjekësore
9. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH

Buxheti i planifikuar për realizimin e këtyre projekteve, ka kapur vlerën e **1,500,000.00** eurosh. Nga ky buxhet janë shpenzuar **1,489,332.00** apo rreth **99.29 %** të këtyre mjeteve.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur në mënyrë grafike raportin për shpenzimin dhe mbetjen buxhetore për këtë kategori, si dhe ndarjen e buxhetit nga kjo kategori për secilin projekt si dhe shpenzimin dhe mbetjen buxhetore nga këto projekte.




1.1. Furnizimi me autoambulanca

Për këtë projekt DKSH ka pasur në dispozicion shumë prej **150,000.00** eurosh për vitin 2024.

Pas nënshkrimit të kontratës për furnizim me autoambulanca, është bërë furnizimi me dy automjete të tilla, të cilat do të ndihmojnë në kryerjen e shërbimeve urgjente për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Buxheti i shpenzuar për blerjen e tyre kap vlerën prej **147,762.00** euro.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të planifikuar për këtë projekt si dhe disa fotografi me rastin e pranimit të tyre.



Furnizimi me autoambulanca

1.2. Furnizimi me mamograf

Për furnizimin me aparat të ri të mamografisë për QKMF, në vitin 2024 janë planifikuar gjithsej **120,000.00** euro.

Kontrata e nënshkruar për blerje të këtij aparati, ka kapur vlerën e **119,990.00** euro.

Me anë të këtij aparati të ri, synohet që të ofrohen shërbime sa më të mira për pacient, sidomos në aspektin e detektimit të hershëm dhe parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit tek pacientët.

Më poshtë gjeni në formë grafike të dhënat mbi buxhetin e shpenzuar si dhe disa fotografi me rastin e funksionalizimit të këtij aparati.



Furnizimi me aparat të mamografisë


1.3. Ndërtimi i QMF-së në fshatin Korishë

Ky projekt i filluar në vitin 2022 dhe ka qenë i planifikuar që të përfundoj gjatë vitit 2023. Mirëpo për shkaqe administrative, një pjesë e vogël e projektit ka mbetur që të përfundohet gjatë vitit 2024.

Pas përfundimit të punimeve është bërë pranimi teknik i objektit dhe tanimë mbetet vetëm furnizimi me inventar për ta bërë funksional këtë objekt.

Vlera e mbetur për pagesë për vitin 2024 nga ky projekt ka qenë **23,557.19** euro dhe si shkak i mungesës së kodit ekonomik për pagesë, kjo shumë është marrë përmes procedurave përmbarimore nga ana e OE.

Këtu gjeni edhe disa fotografi lidhur me projektin në fjalë pas përfundimit të tij.



QMF në fshatin Korishë pas përfundimit



1.4. Ndërtimi i QKMF-së në ish kampin e KFOR-it

Ky projekt ka filluar të implementohet që nga viti 2022.

Duke pasur parasysh që është projekt shumë vjeçar, për këtë vit DKSH ka planifikuar një buxhet prej **580,000.00** eurosh për realizimin e disa fazave të këtij projekti, pasi që komplet realizimi i projektit kap shifrën e rreth **2,536,218.50** eurosh, me kontratën fillestare me vlerë **2,323,000.00** euro, si dhe punët shtesë të miratuara në vlerë prej **99,646.50** eurosh me aneks kontratën e parë dhe **113,572.00** eurosh me aneks kontratën e dytë.

Buxheti i planifikuar për 2024 në vlerë prej **580,000.00** eurosh është shpenzuar në tërësi.

Më poshtë gjeni diagramin lidhur me realizimin e buxhetit të këtij viti për këtë projekt si dhe disa fotografi lidhur me gjendjen aktuale të projektit.



Objekti i QKMF tek ish kampi i KFOR

1.5. Ndërtimi i QMF-së në lagjen e Trimave (Tusuz)

DKSH gjatë vitit 2024 ka planifikuar që të fillojë punimet për ndërtimin e një QMF-je të re në lagjen Tusuz. Ky projekt është planifikuar që të jetë projekt shumë vjeçar për të cilin janë planifikuar gjithsej **800,000.00** euro për realizim të tij.

Gjatë këtij viti, pas përfundimit të procedurave tenderuese, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **770,262.65** eurosh dhe kanë filluar punimet e parapara.

Për vitin 2024, për këtë projekt janë planifikuar që të shpenzohet vlera prej **100,000.00** eurosh, të cilat janë shpenzuar në tërësi.

Më poshtë gjeni në mënyrë grafike shpenzimin e buxhetit nga ky kod dhe disa fotografi lidhur me punimet e kryera nga ky projekt.



Projekti, gurthemeli i QMF në lagjen Tusuz dhe punimet aktuale

1.6. Blerja e aparaturave jo mjekësore

Për blerjen e aparaturave jo mjekësore për vitin 2024, kanë qenë të planifikuara **50,000.00** euro.

Nga kjo kategori, kemi hapur procedura tenderuese dhe nënshkruar kontrata për dy lloje furnizimesh: furnizim me gjenerator për nevojat e objekteve të KPSH, si dhe furnizim me paisje elektronike.

Për furnizim me gjenerator, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **18,880.00** euro, ndërsa për furnizim me paisje elektronike, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **23,850.00** euro.

Në tërësi, nga ky kod për blerjen e këtyre paisjeve janë shpenzuar gjithsej **42,730.00** euro.

Grafikisht të dhënat mbi shpenzimet nga ky kod i gjeni më poshtë:



1.7. Digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike

Për këtë projekt për vitin 2024 janë paraparë gjithsej **250,000.00** euro nga ana e DKSH.

Mirëpo pas analizimit të gjendjes aktuale dhe panevojshmërisë së një projekti të tillë, është vendosur që ky projekt të pezullohet dhe të mos realizohet.

Buxheti i planifikuar për këtë projekt është përdorur për pagesat e ndryshme të cilat janë realizuar përmes procedurës përmbarimore nga operatorë të ndryshëm ekonomik, për fatura të cilat nuk kanë mundur që të realizohen në mënyrë të rregullt.

Nga ky buxhet janë shpenzuar gjithsej **249,000.00** euro.


1.8. Furnizimi me aparatura stomatologjike

Për vitin 2024 për këtë projekt kanë qenë të planifikuara vetëm **10,000.00** euro.

Pasiqë blerja e këtyre aparaturave ka qenë në proces të prokurimit që nga viti 2023 mirëpo këto procedura nuk kanë përfunduar brenda vitit 2023, kontrata e nënshkruar ka kapur vlerën e **23,890.00** eurove pasiqë kjo ka qenë vlera e parashikuar për vitin 2023.

Si kontratë e trashëguar, 10,000.00 eurot e planifikuara për vitin 2024 janë shpenzuar për pagesë të aparaturave të blera sipas kësaj kontrate, ndërsa vlera e mbetur prej **13,890.00** eurosh është realizuar përmes procedurave përmbarimore si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore për këtë projekt.

Grafikisht, buxheti i planifikuar dhe shpenzuar duket si në vijim:



1.9. Blerja e aparaturave mjekësore


Për këtë projekt, DKSH ka pasur të ndara gjithsej 30,000.00 euro për vitin 2024.

Për këtë projekt, në fillim të vitit kemi trashëguar kontratën nga viti 2023 ku është bërë furnizimi me ultrazë në vlerë prej **17,500.00** eurosh.

Duke parë se pas realizimit të kësaj kontrate kanë mbetur akoma mjete për blerje të aparaturave mjekësore, është hapur procedurë e re tenderuese dhe më pas është nënshkruar kontrata me vlerë prej **12,490.00** eurosh për furnizim me paisje siq janë: stetoscop, tensiometër, otoscopoe, termometer, etj.

Në total, nga këto të dy kontrata është shpenzuar shuma prej **29,490.00** eurosh.

Më poshtë gjeni një grafikun lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit të planifikuar për këtë projekt.



1.10. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH

Për realizimin e këtij projekti, për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara **210,000.00** euro.

Për këtë projekt, fillimisht është nënshkruar kontrata në vlerë totale prej **184,225.00** eurosh, sipas së cilës është bërë furnizimi dhe montimi i aparaturave përkatëse në QMF 1.

Më pas, për shpenzimin total të vlerës së parashikuar, DKSH ka hapur rishtazi procedurat e prokurimit, duke nënshkruar edhe kontratën e dytë në vlerë prej **52,228.20** eurosh, kontratë e cila është në realizim e sipër dhe furnizimet sipas së cilës janë duke u bërë në QMF Arbanë.

Nga buxheti i planifikuar për këtë vit, janë shpenzuar gjithsej **209,860.00** euro për të dyja këto kontrata.

Grafikisht, gjeni më poshtë të paraqitur shpenzimin buxhetor për këtë projekt.




2. Mallrat dhe shërbimet

Buxheti i planifikuar për projektet të cilat hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2024, ka qenë **2,145,841.00** euro.

Nga ky buxhet, vlera e shpenzuar për këtë vit kap vlerën e **2,094,495.03** eurosh, përkatësisht rreth **97.61%** të buxhetit të planifikuar.

Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar, do të dukeshin si më poshtë në formë grafike:




Shumica e projekteve nga kjo kategori, janë projekte të cilat kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme, me anë të së cilave mundësohet ofrimi sa më i mirë i shërbimeve shëndetësore dhe të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve të përditshme të institucioneve shëndetësore, përfshirë këtu furnizimet me reagenca laboratorike, me filma rtg, me gaz medicinal, me dru, me pelet, me barna, me material shpenzues sanitar, material higjienik, material administrativ, etj.

Mirëpo ka edhe projekte të shërbimeve dhe punëve siç janë mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH, mirëmbajtja e oborreve dhe kopshteve në institucionet e KPSH, ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së, sigurimi fizik i objekteve të KPSH, mirëmbajtja e paisjeve teknike, mirëmbajtja e aparaturave mjekësore, trajnimi i profesionistëve shëndetësor, etj.


Nga vlera e shpenzuar nga kjo kategori, shuma prej **248,294.32** euro janë marrë përmes procedurave përmbarimore nga ana e operatorëve ekonomik, ndërsa shuma prej **387,617.92** është bartur për pagesa të borgjeve nga ana e DSHP.

Ky buxhet është shpenzuar në vlerat e paraqitura për disa nga projektet e ndryshme sipas grafikorit të mëposhtëm:


Buxheti i shpenzuar projekte të ndryshme nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve




Nga këto projekte të mësipërme, vlen të veçohet projekti i mirëmbajtjes dhe renovimit të objekteve shëndetësore, ku kemi realizuar shumë punë nëpër njësitë shëndetësore, duke funksionalizuar objektin e AMF në fshatin Lubizhdë e Hasit, kemi përmirësuar infrastrukturën e AMF në Skorobisht, kemi adaptuar hapësirat e bodrumit të objektit të QKMF-së duke i kthyer të njëjtat në depo qendrore për QKMF-në, etj. Më poshtë do të bashkangjesim disa fotografi lidhur me realizimin e këtyre punimeve.




Renovimi i tërsishëm AMF Lubizhdë e Hasit



Renovimi i tërsishëm AMF Skorobisht



Renovimi i hapësirave të bodrumit të QKMF për depo qendrore




Renovimi i hapësirave, ndriqimit dhe pllakave në QMF Zhur

3. Shpenzimet komunale

Për mbulimin e shpenzimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, furnizimin me rrymë, mbledhjen e mbeturinave, etj, nëpër të gjitha institucionet e shëndetësisë primare, përfshirë QKMF-në, QMF-të, AMF-të në Komunën e Prizrenit, DKSH për vitin 2024 ka planifikuar për shpenzim shumë prej **100,000.00** eurosh. Nga ky buxhet, gjatë periudhës 12 mujore është shpenzuar gjithsej **94,773.20** euro, ose shprehur në përqindje rreth **94.77%**.

Buxheti i shpenzuar dhe i mbetur, do të dukeshin si më poshtë:



4. Shërbimet shëndetësore


Komuna e Prizrenit, shërbimet shëndetësore për qytetarët e saj i ofron përmes njësive shëndetësore siç janë QKMF, QMF-të dhe AMF-të.

Gjithsej në tërë territorin e Komunës së Prizrenit janë 44 njësi shëndetësore që ofrojnë shërbime shëndetësore. Prej tyre është 1 QKMF në të cilën ofrohen të gjitha shërbimet shëndetësore të parapara me udhëzimin administrativ për kujdesin parësor shëndetësor, përfshirë këtu edhe shërbimet diagnostike laboratorike dhe radiologjike; 1 qendër e shërbimit urgjent ku ofrohen shërbimet urgjente për qytetarët e komunës; 15 QMF në të cilat ofrohen shërbimet e rregullta shëndetësore, ndërsa në 4 prej tyre edhe shërbimet laboratorike; dhe 27 AMF, në 24 prej të cilave ofrohen shërbimet shëndetësore dhe plotësojnë kriteret përkatëse për ofrim të këtyre shërbimeve.

Këto shërbime ofrohen nga stafi profesional shëndetësor. Numri i të punësuarve në QKMF edhe pse varion nga muaji në muaj si shkak i lëvizjeve të ndryshme, sipas të dhënave të muajit dhjetor të vitit 2024, ky numër është 448 të punësuar. Nga ky numër, 104 prej tyre janë mjek, prej të cilëve 48 mjek specialist të mjeksisë familjare dhe 56 mjek të përgjithshëm, 215 infermier, 28 stomatolog, 38 asistent të stomatologjisë dhe 63 staf tjetër, përfshirë mjek specialist të pediatriisë, radiologjisë, biokimisë, internistikës, teknik laborant, staf administrativ dhe mbështetës, punëtor higjienik, etj.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, DKSH përmes njësive shëndetësore dhe stafit të tyre profesional ka ofruar një numër të madh të shërbimeve shëndetësore. Ky numër arrin shifrën e rreth **924,274** shërbime shëndetësore, duke përfshirë por mos kufizuar në shërbimet si: vizita specialitike mjekësore, vaksinim, analiza laboratorike, rtg, shërbime urgjente, shërbime shtëpiake (geriatrike, shërbime të kujdesit paliativ, etj.), shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime, udhëzime, etj.


Numri i shërbimeve shëndetësore sipas muajve ndahet si më poshtë:



Më poshtë do të shpalojmë numrin e disa prej shërbimeve të ofruara, duke dhënë statistika mujore për numrin e realizuar të këtyre shërbimeve nëpër institucionet shëndetësore.



4.1. Vizitat mjekësore

Në total janë realizuar gjithsej **370,566** vizita mjekësore, prej të cilave **155,703** vizita nga mjeku i përgjithshëm dhe **214,863** vizita specialistike nga mjeku specialist i mjekësisë familjare. Të ndara në muaj, numri i këtyre vizitave është si vijon:



4.2. Vaksinimi


Sipas planifikimit të bërë, për vitin 2024 janë planifikuar për imunizim **12,299** fëmijë nga kalendari i obligueshëm i imunizimit, prej të cilëve janë imunizuar **11,768** fëmijë apo **95.6%** e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë administruar edhe **4,269** doza të vaksinës kundër gripit sezonal, ndërsa vakcina kundër **Covid-19** janë dhënë **29** doza të vaksinës. Më poshtë gjeni grafikisht përqindjen e imunizimit nga kalendari i obligueshëm për fëmijë si dhe aplikimin e vaksinave të ndryshme sipas muajve :



4.3. Shërbimi i Njesisë Diabetike

Njësia diabetike gjatë kësaj periudhe ka ofruar gjithsej **6,569** shërbime shëndetësore për pacient, duke përfshirë vizita për pacient, egzaminime të ECHO abdomenit, matja e glikemisë, vizita për trajtimin e shputës diabetike, etj.


Në grafikonin e mëposhtëm gjeni ofrimin e këtyre shërbimeve në baza mujore:



4.4. Shërbimet laboratorike


Shërbime diagnostike për analiza laboratorike, hematologjike, biokimike dhe në përgjithësi analiza të tjera në laboratorin e QKMF, QMF1, QMF- Reqanë, QMF- Gjonaj dhe QMF - Zhur janë kryer gjithsej **48,893** shërbime.

Grafikoni i mëposhtëm paraqet realizimin e këtyre analizave sipas muajve.




4.5. Shërbimet radiologjike

Shërbime diagnostike radiologjike përfshirë ECHO të gjirit, mamografi, ortopan, RTG, etj., gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej **5,217** shërbime.




Në kuadër të shërbimeve radiologjike të ofruara, vlen të përmendet numri mamografive të realizuara gjatë kësaj periudhe. Në total janë realizuar gjithsej **256** mamografi nga stafi i QKMF. Si shkak i defektit të aparatit të mamografisë, në disa nga muajt e këtij viti nuk është realizuar asnjë mamografi, deri në blerjen e aparatit të ri. Numrin e mamografive të realizuara të ndara në muaj e gjeni më poshtë:




4.6. Shërbimi Urgjent

Shërbime urgjente të ofruara nga Shërbimi Urgjent në kuadër të QKMF-së, përfshirë vizitat në teren, vizitat ambulatore, transportet për spital, vizitat gjatë aksidenteve nga ekipet e urgjencës, vdekjet e konfirmuara nga ekipet e urgjencës, infuzionet, etj., janë realizuar gjithsej **24,106** shërbime gjatë kësaj periudhe.




4.7. Kujdesi shtëpiak

Gjatë kësaj periudhe kohore, janë realizuar gjithsej **8,888** shërbime shëndetësore nga kujdesi shtëpiak, përfshirë këtu shërbimet shëndetësore për të sëmurët në fazën terminale të sëmundjes (kujdesi paliativ), për personat me aftësi të kufizuar dhe që nuk kanë mundësi çasjeje në objektet shëndetësore, shërbime për të moshuarit (kujdesi geriatrik) të cilëve u janë ofruar shërbimet shëndetësore si vizitat mjekësore, dhënjen e injeksioneve, infuzioneve, barërave, vendosjen e kateterit, fashim, etj. Grafikoni i mëposhtëm pasqyron numrin e shërbimeve të ofruara në shtëpi sipas muajve përkatës.



4.8. Ndërrimi i natës


Në kuadër të ndrrimit të natës ose ndryshe ndërrimit të tretë me anë të të cilit kompletohet shërbimi 24 orë për qytetarët, janë ofruar **73,546** shërbime shëndetësore për pacient përfshirë këtu vizitat mjekësore, dhënjën e injeksioneve, infuzioneve, fashim, etj.. Për secilin muaj veç e veç, keni të paraqitur më poshtë numrin e shërbimeve të ofruara.



4.9. Shërbime stomatologjike

Në kuadër të ktyre shërbimeve ku përfshihen vizitat, mbushjet e dhëmbit, nxjerrjet, inqizimet, etj., janë realizuar gjithsej **56,337** shërbime në kuadër të këtij dikasteri të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Prizrenit.

Grafika e mëposhtme jep numrin e shërbimeve mujore në këtë department.




4.10. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë (0-3 vjeç)

Gjatë kësaj periudhe, DKSH përmes ekipeve të QKMF ka ofruar një numër të madh të vizitave për këtë kategori. Në total janë ofruar **3,018** vizita të tilla, prej të cilave **478** vizita për lehona, **2,153** vizita për fëmijë dhe **473** vizita për shtatzëna.

Në kuadër të këtij numri, hyjnë edhe rreth **370** vizita të ofruara për komunitetin RAE për këto kategori, prej të cilave **73** vizita për lehona, **84** vizita për shtatzëna dhe **221** fëmijë të këtij komuniteti.


Më poshtë do të pasqyrojmë këto vizita të ofruara sipas muajve:

Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë (0-3 vjeç)



4.11. Shërbime nga departamenti për shëndetin e gruas

Nga ky departament, për këtë vit janë realizuar gjithsej **2,701** shërbime, përfshirë këtu **558** vizita gjinekologjike (deri në muajin nëntor pasiqë mjeku ka dalë në pension), **462** strisho vaginale, **1,000** papa teste, **207** ECHO gjinekologjike (deri në muajin nëntor pasiqë mjeku ka dalë në pension), etj. Të ndara sipas muajve, gjeni këto shërbime të bashkangjitura më poshtë:




4.12. Shërbimet nga Barnatorja qendrore

Gjithsej gjatë këtij viti, kanë marrë shërbime në barnatore **38,013** pacient, prej të cilëve **13,601** janë furnizuar me insulina ndërsa **24,412** me barëra të tjerë. Gjithashtu nga barnatorja janë furnizuar edhe të gjitha njësitë shëndetësore të KPSH në Prizren për përmbushjen e nevojave të tyre për ofrimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore për pacient.


Përgjatë muajve, furnizimet janë bërë si më poshtë:

SHËRBIMET NGA BARNATORJA QENDRORE

Numri total i pacientëve
 Numri i pacientëve të furnizuar me insulina
 Numri i pacientëve të furnizuar me barna të tjerë
 Numri i njësive shëndetësore të furnizuara




Bazuar në planifikimin e bërë dhe në përqindjen e furnizimit nga ana e Ministrisë gjatë këtij viti, më poshtë gjeni të pasqyruar raportin për furnizim me barna, material sanitar dhe insulina:



4.13. Shërbime të tjera shëndetësore

Në grafikonin e mëposhtëm do të paraqesim edhe numrin total të disa prej shërbimeve të tjera të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe.



5. Subvencionet


Duke filluar nga muaji mars e deri më 22 nëntor 2024, është bërë pranimi i dokumentacioneve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Fluksi i personave që kanë aplikuar për mbështetje ka qenë mjaft i madh. Gjatë kësaj periudhe, janë parashtruar **1,127** kërkesa për mbështetje financiare nga këto kategori. Prej tyre, janë aprovuar **1,105** kërkesa të parashtruara ndërsa janë refuzuar **22** prej tyre si shkak i mospërmbushjes së kriterëve të parapara me rregullore. Prej kërkesave të aprovuara, për **919** kërkesa është realizuar pagesa, përkatësisht për kërkesat e parashtruara nga muaji mars deri në muajin gusht 2024. Për 186 kërkesa të tjera të parashtruara gjatë muajit shtator, tetor dhe nëntor janë marrë vendimet nga kryetari për aprovim, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, të njëjtat kanë mbetur që të realizohen gjatë vitit 2025.

Për 919 kërkesat për të cilat është realizuar pagesa, janë shpenzuar gjithsej **368,000.00** euro.

Gjithashtu, është realizuar pagesa për **271** persona kërkesat e të cilëve janë pranuar më 2023, mirëpo si shkak i mungesës së mjeteve financiare më 2023 janë përcjellur për realizim më 2024. Shuma që është ndarë për këta persona kap vlerën e **108,400.00** eurosh.

Në total, shuma me të cilën janë mbështetur këto raste, pa përfshirë 186 kërkesat e parashtruara gjatë muajve shtator-nëntor 2024, kap vlerën e **476,400.00** eurove.

Nga totali i përfituesve për të cilët janë realizuar pagesat gjatë 2024, përfshirë këtu edhe kërkesat e bartura nga 2023, kanë përfituar komunitetet si më poshtë:



6. Shënimi i Ditëve Botërore

DKSH me aktivitete të ndryshme, ka bërë shënimin e ditëve botërore të përcaktuara me kalendarin botëror të shënimin të këtyre ditëve. Më poshtë gjeni të radhitura Ditët Botërore për të cilat DKSH ka realizuar aktivitetet e saj.

Emri i ditës botërore	Koha e shënimin të saj	Aktiviteti
Dita Botërore e Kancerit	02 shkurt 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shpërndarja e broshurave vetëdijësuese nëpër institucionet e KPSH 2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e TBC	25 mars 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitet vetëdijësues në Sheshin e Lidhjes 2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Java Botërore e Imunizimit	24-26 prill 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitete vetëdijësuese nëpër QMF 2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e Hipertensionit	17 maj 2024	<ol style="list-style-type: none"> 3. Aktivitete vetëdijësuese nga ekipet mobile shëndetësore të vendosura në Galeria Shopping Mall dhe Sheshin e Lidhjes për qytetarët 1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e Abuzimit të Drogave	26 qershor 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Muaji i Kancerit të Gjirit	01-30 tetor 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë këtij muaji, janë realizuar vizita rutinore për gra, ku janë përfshirë vizita specialistike, eho dhe mamografi nga mjeku specialist. Gjithashtu janë realizuar aktivitete

		vetëdijësuese, ligjerata dhe takime me grupe të ndryshme nga ana e profesionistëve shëndetësor.
Dita Botërore e Diabetit	14 nëntor 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitet në hapësira publike nga ekipet mobile të QKMF ku është ofruar matja e sheqerit në gjak si dhe këshilla për qytetarët e rastit 2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e HIV/AIDS	1 dhjetor 2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor

Më poshtë do të bashkangjesim edhe disa fotografi nga aktivitetet e ndryshme të realizuara në kuadër të shënimit të këtyre ditëve.



Aktivitete të realizuara për shënimin e Muajit Rozë



Aktivitetet e shënuara për Ditën Botërore të Diabetit



Aktivitete të shënuara për Javën Botërore të Imunizimit



Aktivite të shënuara për Ditën Botërore të Hipertensionit



Aktivite të shënuara për Ditën Botërore kundër Abuzimit me Substanca Narkotike

7. Aktivitete të tjera

Përgjatë kësaj periudhe, DKSH ka realizuar edhe një numër të konsiderueshëm aktivitetesh të ndryshme. Më poshtë do të shpalosim disa prej këtyre aktiviteteve.

Drejtori i DKSH në fillim të vitit ka realizuar vizita njoftuese dhe informuese nëpër njësitë shëndetësore, si në QMF ashtu edhe në AMF duke parë gjendjen dhe nevojat aktuale të stafit dhe të objekteve përkatëse.

Gjatë muajit mars, në bashkëpunim me KFOR-in, janë realizuar trajnime në aspektin teorik dhe praktik për puntorët e Shërbimit Urgjent lidhur me menagjimin e rasteve të ndryshme urgjente, ku pas përfundimit të këtij trajnimi, janë shpërndarë çertifikata për punëtorët shëndetësor pjesëmarrës në këto trajnime.

Gjatë muajit prill është pranuar një donacion me paisje mjekësore dhe jo mjekësore nga CIMIC në kuadër të KFOR-it Italian.

Në muajin maj është realizuar një takim me KFOR-in Italian në hapësirat e AMF në Mushnikovë ku edhe më pas është bërë pranimi i donacionit me paisje mjekësore të ofruar nga ta për këtë AMF.

Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar vizitat sistematike të nxënësve të klasëve 1, 5 dhe 9 të shkollave të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit.

Gjatë muajit korrik DKSH ka mbajtur takim informues për punën e saj gjatë gjashtë mujorit të parë me Komitetin Komunal për Shëndetësi ku ka njoftuar të njëjtin me punën dhe aktivitete e DKSH për këtë periudhë.

Gjatë muajit shtator është bërë përrurimi dhe funksionalizimi i aparatit të ri të mamografisë të blerë me bugjetin e planifikuar për vitin 2024, ku do të mundësohet realizimi dhe detektimi i hershëm i rasteve të reja me kancerin e gjirit. Në QKMF është organizuar aktivitetet e dhënjes vullnetare të gjakut.

Gjatë muajit tetor, është bërë zyrtarisht pranimi dhe përrurimi i furnizimit me 2 autoambulanca nga ana e Kryetarit të Komunës dhe stafit të DKSH.

Në muajin nëntor është vendosur gurthemeli për ndërtimin e QMF-së së re në lagjen Tusuz. Gjatë këtij muaji poashtu është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet DKSH dhe Shoqatës për Mbrojtjen e Pacientëve të Kosovës. Gjithashtu brenda këtij muaji është bërë përrurimi i hapësirave të renovuara tek Lartorja e QKMF-së, investim ky i ardhur si donacion nga KFOR-i Turk. Gjatë muajit dhjetor, është bërë organizimi i punëtorisë në Shqipëri lidhur me të gjeturat e dala nga realizimi i vizitave sistematike për nxënësit e klasave I,V dhe IX të shkollave të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit. Në këtë muaj DKSH ka pranuar donacion me paisje mjekësore dhe jo mjekësore nga Ambasada e Bullgarisë. Gjatë këtij muaji është formuar Këshilli i Pacientëve në Komunën e Prizrenit, ku DKSH ka hapur fillimisht thirrjen publike e më pas ka bërë përzgjedhjen e antarëve të këtij këshilli.

Gjithashtu, përgjatë tërë vitit, zyrtarë të DKSH kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të thirrura nga institucione të shumta lidhur me tema dhe çështje të ndryshme, duke dhënë kontributin e tyre dhe duke shpalosur punën dhe aktivitetet e DKSH. Poashtu, DKSH ka marrë pjesë përmes zyrtarëve të saj edhe në komisione të ndryshme komunale të formuara nga Kryetari, qoftë për hartim të akteve të

ndryshme komunale apo për funksionim adekuat të grupeve të ndryshme punuese të formuara nga komuna.

Më poshtë do të bashkangjisim edhe disa fotografi lidhur me disa nga aktivitetet e realizuara.



Përurimi i mamografit të ri



Pranimi i furnizimit me autoambulanca



Dhënja vullnetare e gjakut në hapësirat e QKMF-së



Realizimi i vizitave nëpër institucione të KPSH nga ana e Drejtorit të DKSH



Pranimi i donacionit nga KFOR-i për AMF në Mushnikovë



Përrurimi i hapësirave të renovuara tek lartorja e QKMF nga KFOR-i Turk



Realizimi i vizitave sistematike për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9 të Komunës së Prizrenit



Realizimi i punëtorisë lidhur me të gjeturat nga vizitat sistematike



Vizita gjatë realizimit të trajnimeve për profesionistët shëndetësor

Prizren
Janar 2025



Drejtori i DKSH

Simir Krasniqi